

L I G J
Nr.8021, datë 1.11.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7936, DATË 18.5.1995 “PËR DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr.7936, datë 18.5.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore” pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Automjetet dhe pajisjet e zyrave që importohen për Kuvendin Popullor, Presidencën, Këshillin e Ministrave, përjashtohen nga taksat doganore në një shumë deri 50 000 000 lekë në vit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1273, datë 3.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha